



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER FRIDA MUÇMATAJ
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 2, RR. GEORGE BUSH, GODINA
NR. 3
TEL: 0692544390

KONTRATË SHITJE PASURIE E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 636

Nr. koleksioni: 221

Tirane më 19/06/2020



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2020053800014645730



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "LA MAISON" SH.P.K)

Sot, më datë 19-06-2020 , para meje Notere FRIDA MUÇMATAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 2, RR. GEORGE BUSH, GODINA NR. 3, u paraqit personalisht:

-Në cilësinë e Shitësit: **Z. Nektar KUME**, shtetas shqiptar, atësia Polikron, lindur në Tiranë në 29-04-1976 , banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimi me nr. personal H60429138I, cel 0697295548. zotërues i 1(një)kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë "La Maison" shpk.

- Në cilësinë e Blerësit: **Zj. Iri NDROQI**, shtetase shqiptare, atësia Bajram, lindur në Tirane në 08-05-1986, banues Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimi me Nr. personal I65508070N, Shitësi dhe Blerësi janë referuar me poshtë individualisht si "Pala" dhe se bashku si "Palët".

Baza Ligjore: Ligjin nr .9901 datë 14-04-2008 "Për Tregtaret Shoqëritë Tregtare", Neni 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20-12-2018 "Për Noterinë".

Objekti: Shitblerje e 1 Kuote të shoqërisë "La Maison" shpk.

Rrethanat për hartimin e aktit noterial:

DEKLARATA PARAPRAKE:

Shoqëria "La Maison" shpk, regjistruar në QKB me NIPT-t L81610009A, me adrese në Tiranë rr."Ismail Qemali" nr. 12/1 ". ("Shoqëria");

- I. Kapitali i Shoqërisë ("Kapitali") është 100.000 (njëqind mijë) Lek, me Nr. të përgjithshëm të kuotave 1(një).
- II. Pala Shitëse z. **Nektar KUME** është pronar i ligjshëm dhe zotëruese e 1(një) kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë të cilën do ta shes në vlere 100.000 (njëqind mijë) Lek;

Duke u mbështetur në ligjin nr .9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtaret Shoqëritë Tregtare", me Vendimin e ortakeve Nr. 2, date 19-06-2020. Asambleja dhe Ortakut ka vendosur transferimin nëpërmjet shitjes se një kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë me vlere 100.000 Leke, nga ortaku shoqërisë z. **Nektar KUME** tek blerësi zj. **Iri NDROQI**, e cila pas këtij transaksioni do të zotërojë 1 (një) kuote që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi 1(një) kuotë të tij e cila përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë;

Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj kontrate për shitblerjen e kuotave nëpërmjet Palës Shitëse dhe Palës Blerëse ("Kontrata"), si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

Shitja e 1(një) kuote e barabarte 100% kapitalit të shoqërisë "La Maison" shpk të zotëruara nga ortaku z. **Nektar KUME**. Këto kuota blihen nga blerësi zj. **Iri NDROQI**. Pas këtij transaksioni ortak i shoqërisë do të jete vetëm zj. **Iri NDROQI** që zotëron 1(një) kuote të barabarte me 100% të kapitalit të shoqërisë.

1.1 Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ("Data e Nënshkrimit"), Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi 1(një) kuote që përfaqëson 100%, të kapitalit të Shoqërisë të lira nga çdo Barre.

1.2 Çmimi i rene dakord për shitjen e 1(një)kuote e barabarte 100% kapitalit të shoqërisë është në shumën 100.000 Leke .



1.3 Shitësi dhe Blerësi bien dakord për të përfunduar dhe dorëzuar me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë çdo dokument të nevojshme në përgjithësi për të bere gjithçka është e nevojshme për të regjistruar kuotat e transferuara subjekt të kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të autoriteteve shqiptare të kërkuara sipas legjislacionit shqiptar.

1.4 Kuotat transferohen nga pronësi e Shitësit në pronësi të Blerësit në Datën e Nënshkrimit.

1.5 Pagesa e Çmimit të përcaktuar në Nenin 1. 2. do te behet me nënshkrimin e kontratës.

Neni 2

Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

2.1 Shitësi deklaron dhe garanton në lidhje me transaksionin që parashikohet në këtë Kontrate, për të gjitha çështjet që vijnë.

2.1.1 Te gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Shitësit dhe që autorizojnë Shitësin të lidhe dhe të zbatoje këtë Kontrate janë kryer rregullisht; kjo Kontrate është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përben një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

2.1.2 Detyrimet tatimore të cilat rrjedhin nga transferimi i aksioneve me ane të shitjes sipas kësaj kontrate dhe që mblidhen sipas legjislacionit shqiptar, në rast se do të ketë të tilla, do te paguhen nga shitësi.

Neni 3

Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

3.1 Blerësi bën deklaratimet dhe i jep garancitë e mëposhtme Shitësit.

3.1.2 Të gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Blerësit dhe që autorizojnë Blerësin të lidhe dhe të zbatoje këtë Kontrate janë kryer rregullisht. Kjo Kontrate është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Blerësi dhe përben një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Blerësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

Neni 4

Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni kompetent

4.1 Kjo Kontrate rregullohet nga ligjislacioni Shqiptar.

4.2. Çdo konflikt në lidhje me, interpretimin, zbatimin, zgjidhjen, përfundimin e Kontratës do të zgjidhet nga juridiksioni kompetent gjyqësor shqiptar.

Neni 5

Të ndryshme

5.1 Ndryshimet

5.1.1 Çdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonjë prej dispozitave te kësaj Kontrate, do të jete e vlefshme vetëm nëse behet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Pale.

5.1.2 Mosushtimi ose vonesa ne ushtimin e një te drejte ose mase mbrojtje, qe parashikohen ne këtë Kontrate ose nga ligji, nuk përben heqje dore nga e drejta ose masa e mbrojtjes, ose heqje dore nga te drejta ose masa te tjera mbrojtjeje. Mosushtimi i vetëm ose i pjesshëm i një te drejte ose mase mbrojtjeje qe parashikohen ne këtë Kontrate ose nga ligji, nuk pengon ushtimin e mëtejshëm te se drejtës ose masës mbrojtëse ose ushtimin e një te drejte ose mase tjetër mbrojtjeje.

5.2 Vlefshmëria e pavarur nga njëra tjetra e dispozitave kontraktore

5.2.1 Ne rast se një dispozite ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm ne një juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve ne një juridiksion tjetër, nuk do te preket nga një fakt i tille.

5.2.2 Palët do te përpiqen te zëvendësojnë një dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masën me te madhe te mundshme, për te arritur qëllimin e kësaj dispozite.

Kopjet

Kjo Kontrate nënshkruhet ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Asnjëra Pale nuk mund te kaloje dhe / ose te transferoje te drejtat dhe / ose detyrimet sipas kësaj Kontrate, në tërësi ose ne veçanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Palës tjetër.

Kjo Kontrate përben marrëveshjen e plote dhe zëvendëson çdo marrëveshje te mëparshme midis Palëve qe




lidhet me objektin e kësaj Kontrate.

Unë, noteri, pasi ua lexova palëve këtë kontratë me zë të lartë dhe pasi palët me vullnet të plotë dhe të lirë deklaruan se janë dakord me sa me sipër e nënshkruajnë pa asnjë vërejtje në praninë time dhe unë noterja, pasi e gjej në përputhje me ligjin e vërtetë nënshkrimin e tyre sipas ligjit për Noterinë “.

SHITES
Nektar KUME

Palët në Kontratë

NOTERE
Frida MUÇMATAJ



BLERES
Irisi NDROQI

